



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A**  
**Lagjia “Kushtrimi” Rruga “Arkobaleno” [Tel:033604060](tel:033604060)**

---

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_2023

**PROCES-VERBALI TIP MALLRA/SHERBIME/PUNE**

**Lënda:** Argumentim për vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikave teknike të argumentuara sipas proces –verbalit tip për mallra dhe shërbime sipas formatit të APP-se

**Objekti i kontratës:** "Blerje Rroba Pune "- "Procedurë e hapur e thjeshtuar Mallra ,

**Numri i referencës :** REF 75229- 07-17-2023

**Fondi Limit:** 2,637,630 leke pa tvsh.

**Kodi i fjalorit PVC –ja** Veshje profesionale 18110000-3 ,Veshje profesionale rroba pune të vecanta dhe aksesori 18100000-0

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor (AK) për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të Ligjit Nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në nenin 77 pika 1 dhe pika 4, i cili parashikon se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas njëstandardi të përshtatshëm cilësie”.*

Në bazë të kriterëve të veçanta të kualifikimit hedhur në sistemin e APP<sup>se</sup> sipas Dokumentave Standarte të Tenderit (DST) AK hartoi DST<sup>en</sup>, mbështetur në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke përcaktuar kërkesat e veçanta për kualifikim.  
(përveç kriterëve të përgjithshme që janë të pa ndryshueshme në DST)

Për sa më sipër AK argumenton këto kritere, referuar VKM Nr.285/ 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V "Dokumentet e Tenderit":

### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij objektin e kësaj procedure prokurimi.**

*Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 pika 1 ku për të vërtetuar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës kryen veprimtari sipas objektit të procedurës së prokurimit, AK kërkon nga OE paraqitjen e një dokumenti ligjor i cili shërben për të vërtetuar veprimtarin që OE kryen si dhe është ose jo në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit.*

### **2.2 Kopje te bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, nga të cilat dalin qartë të dhënat për vlerat e furnizimeve, për vitet 2022.**

*Vendosja e kërkesës, është në mbështetje të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" , neni 77 [...] në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën [...] si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 4 [...] operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në Ibilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

### **2.3. Për kapacitetin teknik: Te kete Kontrate te ngjashme jo me pak se 40% e fondit limit per objektin e prokuruar.**

Referuar Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 77 pika 4 parshikon: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

1.2.1 Furnizime te mëparshme, të ngjashme, ne nje vlere deri ne 40% te fondit limit për të cilat OE merr pjese. Furnizime këto të realizuara gjatë pese viteve të fundit (2020, 2021, 2022) nga data e zhvillimit të tenderit.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori pjesëmarrës duhet të paraqese, vërtetim të lëshuar nga enti publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes dhe kontratat, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Vendosja e këtij kriteri tregon faktin që operatorët ekonomike kanë realizuar gjatë tre viteve të kërkua kontrata të ngjajshme të përmasave të tilla me objektin që prokurohet. Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik", neni 77 pika 4 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 2/c.*

Referuar Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 79 pika 1 parshikon se: *Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkua të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.*

**1.2.2 Çertifikatë ISO 9001**-për prodhuesin e produkteve të ofruara (ekuivalente) – *në rastin e shpalljes fitues të operatorit ekonomik kurse në rastet kur dorëzon kërkesën për pjesëmarrje mund të sjellë një vetdeklarim në lidhje me prodhuesin që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.*

*Çertifikatat ISO 9001, ISO 14001, përcakton kriteret për një sistem të administrimit të kualitetit. Nepermjet implementimit të kësaj norme ndërkombetare Operatori Ekonomik provon aftësinë e tij për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme produkte të cilat janë në përputhje me kërkesat e klientit si dhe ato ligjore.*

**3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkua. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. (Autorizimi të jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).**

*Këto kritere mbështeten në ligjin Nr.162, datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", neni 79.*

**4-Te kete skede teknike sipas standarteve ne specifikimet teknike nga firma prodhuese per artikujt sipas DST dhe preventivit,ku te pasqyrohen specifikimet teknike per secilin artikull te ofruar.**

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Elona HODAJ  
ADMINISTRATOR**